



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.04/ L-179, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës propozon :

Në bazë të neneve 11, 12 par.12.2 shkronja c), 16 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 32 par.5 të Ligjit Nr.04/L-179 për Transportin rrugor, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.21 e datës 13.06.2013 si dhe neneve 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e datës ____2014 miratoi këtë

PROJEKT

RREGULLORE PËR TRANSPORTIN E UDHËTARËVE ME AUTOMJETE TAKSI

I. DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i miratimit të Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksi (në vazhdim të tekstit: Rregullore) është që Komuna në pajtim me Ligjin Nr.04/L-179 për Transportin rrugor të krijoj kushte për ofrimin e shërbimeve të transportit të udhëtarëve dhe të rregulloj mënyrën e kryerjes së veprimtarisë të personave fizik dhe juridik të regjistruar për transportin e udhëtarëve me automjete taksi.

Neni 2 Objekti i rregullimit

Me këtë Rregullore përcaktohet objekti i rregullimit, si vijon:

Subjektet për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve me automjete taksi, Licenca dhe kushtet për lëshimin e Licencës, procedura e lëshimit, revokimit dhe e marrjes së të Licencës, caktimi dhe dhënia në shfrytëzim e vendparkingjeve, ushtrimi i veprimtarisë, evidencat, detyrat për zbatimin e rregullores, masat për mosrrespektimin e rregullores, procedura e ankesave, dispozitat kalimtare dhe dispozitat për hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 3
Subjektet për ushtrimin e veprimtarisë

Në pajtim me Ligjin për Transportin rrugor dhe me këtë Rregullore, të drejtë për bartjen e udhëtarëve me automjete taksi në territorin e Komunës së Lipjanit kanë personat fizik dhe juridik të regjistruar për kryerjen e veprimtarisë të transportit të udhëtarëve me automjete taksi (në vazhdim të tekstit: Operatorët), të cilët posedojnë Licencën dhe automjetet me të drejtë të shfrytëzimit të vendparkingut të caktuar për automjete taksi.

II. LICENCA DHE KUSHTET PËR LËSHIMIN E LICENCËS

Neni 4
Licenca

1. Licenca është akt me të cilin i lejohe operatorit ushtrimi i veprimtarisë së transportit të udhëtarëve me automjete taksi në territorin e Komunës së Lipjanit sipas kushteve të përcaktuara me Ligjin për Transportin rrugor dhe me këtë Rregullore.
2. Formën dhe përmbajtjen e Licencës në pajtim me Ligjin dhe me këtë Rregullore e përcakton Drejtorati i shërbimeve publike
3. Licenca i lëshohet operatorit – personit fizik për ushtrimin e veprimtarisë të transportit me 1 (një) automjet taksi, ndërsa personit juridik për ushtrimin e veprimtarisë me më së shumti _____ automjete taksi.
4. Licenca lëshohet në emër të operatorit dhe nuk mund të bartet te personat e tretë.
5. Licencën e lëshon Drejtorati për Shërbime publike në kohëzgjatje prej 5 vite.
6. Për marrjen e Licencës operatorët duhet të plotësojnë kushtet e përcaktuara me nenin 5 të kësaj Rregulloreje.
7. Aplikimi për marrjen e licencës bëhet përmes konkursit publik.

Neni 5
Kushtet për licencim

Operatorët për marrjen e Licencës duhet të plotësojnë kushtet në vijim:

- 1.1 Të jenë të regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë të transportit të udhëtarëve me automjete taksi,
- 1.2 Të kanë selinë e biznesit në territorin e Komunës së Lipjanit,
- 1.3 Personat fizik të kenë në pronësi automjetin, ndërsa personat juridik të kenë në pronësi së paku 5 automjete,
- 1.4 Automjeti duhet të jetë i regjistruar me 5 ulëse (4+1) dhe së paku 4 dyer,
- 1.5 Drejtuesit e automjeteve të posedojnë patentë shoferin për kategorinë "B" dhe së paku 5 vite përvojë në drejtimin e automjetit, ndërsa të punësuarit te personi juridik edhe kontratën e punës,
- 1.6 Operatori me vendim të Gjykatës të mos ketë të shqiptuar masë mbrojtëse të ndalimit të kryerjes së transportit të udhëtarëve me automjete taksi,

1.7 Drejtuesi i automjetit të mos ketë të shqiptuar nga Gjykata masën mbrojtëse të ndalimit të drejtimit të automjeteve.

II. PROCEDURA E LËSHIMIT, REVOKIMIT DHE E MARRJES SË LICENCËS

Neni 6 Konkursi publik

1. Kryetari i Komunës merr vendim për shpalljen e konkursit për dhënien e licencave dhe formon Komisionin për shqyrtimin e aplikacioneve të operatorëve. Konkursi shpallet në faqen elektronike të Komunës dhe në dy gazeta ditore.

Neni 7 Dokumentacioni për licencim

Operatorët të cilët aplikojnë për marrjen e licencës, aplikacionit duhet ti bashkëngjeshin dokumentacionin, si vijon:

- 1.1 Fotokopjen e vërtetuar të Certifikatës mbi regjistrimin e biznesit,
- 1.2 Fotokopjen e vërtetuar të dokumentit - Informatat mbi të dhënat e biznesit,
- 1.3 Fotokopjen e vërtetuar të Certifikatës të regjistrimit të automjetit,
- 1.4 Për drejtuesit e automjeteve fotokopjen e vërtetuar të patent shoferit për kategorinë "B", ndërsa për të punësuarit edhe kontratën e punës,
- 1.5. Dëshminë nga Gjykata se Operatorit nuk iu është shqiptuar masa mbrojtëse e ndalimit të kryerjes së transportit të udhëtarëve me automjet taksit,
- 1.6 Dëshminë nga Gjykata se drejtuesit të automjetit – personit fizik dhe drejtuesve të automjeteve të personi juridik nuk iu është shqiptuar masa mbrojtëse e ndalimit të drejtimit të automjeteve.

Neni 8 Shqyrtimi i aplikacioneve

Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve të operatorëve sipas konkursit, në afat prej 5 dite nga dita e skadimit të afatit për konkurrim, shqyrton aplikacionet dhe harton Raportin me listën e operatorëve të cilat i plotësojnë kushtet për dhënien e Licencës, të cilin ia dërgon Drejtoratit për shërbime publike.

Neni 9 Revokimi dhe marrja e Licencës

1. Për revokim, ndërprerje të afatit dhe marrje të licencës vendos Drejtorati për shërbime publike.

2. Licenca do të revokohet nëse vërtetohet se Operatori për marrjen e licencës ka prezentuar dokumentacion i cili nuk përkon me gjendjen reale.

3. Licenca do të pushojë të vlejë, në rastet në vijim:

3.1 Me kërkesë me shkrim të operatorit dhe

3.2 Kur Drejtorati, vërteton se operatori gjatë ushtrimit të veprimtarisë më nuk i plotëson kushtet nga nenet 5 dhe 12 të kësaj rregulloreje.

4. Licenca do ti merret Operatorit në rastet nëse brenda vitit nga Gjykata i janë shqiptuar 4 dënime për kundravajtje të plotëfuqishme të bazuara në nenin 22 par.1 nënparagrafet 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5 të kësaj rregulloreje.

5. Drejtorati i Inspektoratit – Inspektorët e trafikut, konform këtij neni, gjatë mbikëqyrjes inspektive do të njoftojnë Drejtoratin për shërbime publike dhe do ti prezantojnë provat për rastet për të cilat duhet të fillohet procedura për revokim dhe marrje të licencës.

IV. CAKTIMI DHE DHËNIA NË SHFRYTËZIM E VENDPARKINGJEVE

Neni 10 Vendparkingjet

1. Për kryerjen e veprimtarisë të bartjes së udhëtarëve me automjete taksi, Komuna siguron dhe mirëmbanë Vendparkingjet për qëndrimin e automjeteve taksi për marrjen e udhëtarëve.

2. Kryetari i Komunës, në propozim të Drejtoratit për shërbimeve publike dhe Drejtoratit për planifikim, urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit, me Vendim përcakton lokacionet për vendparkingje dhe numrin e automjeteve që mund të vendosen në vendparkingje.

3. Në hyrje të vendparkingut duhet të vendoset shenja vertikale me mbishkrim "TAXI" si dhe shenja e komunikacionit me të cilën ndalohet ndalja dhe parkimi me tabelë plotësuese "Vetëm për automjete taxi", numri i autoparkingut dhe numri i automjeteve që mund të vendosen në autoparking.

4. Për mirëmbajtjen e autoparkingjeve për automjete taksi në pajtim me Ligjin kujdeset Drejtorati i shërbimeve publike.

Neni 11 Dhënia në shfrytëzim e vendeve në vendparking

Vendet për qëndrimin e automjeteve për marrjen e udhëtarëve në vendparkingun e caktuar për automjete taksi, do tu jepen në shfrytëzim operatorëve, sipas kushteve dhe procedurës në vijim:

V. USHTRIMI I VEPRIMTARISË

Neni 12 Dokumentacioni dhe automjetet

1. Para fillimit të ushtrimit të veprimtarisë, operatorët duhet të posedojnë Licencën dhe aktin mbi të drejtën e shfrytëzimit të autoparkingut të caktuar për qëndrim të automjeteve për pranimin e udhëtarëve, si dhe të ndërmarrin veprimet dhe të përgatisin automjetet, si vijon:

1.1 të ketë të ngjyrosur automjetin me ngjyrë të verdhë, të regjistruar, teknikisht në gjendje të rregulltë si dhe pa dëmtime në pjesën e jashtme dhe të brendshme të automjetit,

- 1.2 të posedojë taksimetrin e vendosur në automjet në gjendje të rregulltë, i bazhdaruar nga organi kompetent,
- 1.3 të ketë të vendosur mbi kabinë paralel me erëmbrojtësin tabelën me dimensione standarde e paisur për ndriqim natën me shenjë "TAXI",
- 1.4 të posedojë aparatin për fikjen e zjarrit,
- 1.5 të posedojë sistemin e ngrohjes dhe të ventilimit,
- 1.6 të vendos në anën e djathtë të automjetit Stemën e Komunës, ndërsa personat juridik të vendosin në anën e majtë të automjetit edhe emërtimin e firmës së biznesit,
- 1.7 të vendosin numrin identifikues të automjetit taksi dhe
- 1.8 të paisen me kartelë identifikuese të drejtuesit të automjetit taksi, formën dhe përmbajtjen e së cilës e përcakton me vendim Drejtorati për shërbime publike.

2. Paisjet për operatorët konform nënpar. 1.6 ,1.7 dhe 1.8 të paragrafit paraprak i siguron Drejtorati për shërbime publike.

3. Në automjet, drejtuesi i automjetit, përveq Certifikatës mbi regjistrimin e automjetit dhe patent shoferit, duhet të posedojë :

- 3.1 Kopjen e vërtetuar të Licencës,
- 3.2 Aktin për të drejtën e shfrytëzimit të parkingut,
- 3.3 Kartelën identifikuese, ndërsa i punësuar i personi juridik edhe Kontratën e punës dhe
- 3.4 Çmimoren e shërbimeve.

Neni 13 Verifikimi i automjeteve

1.Verifikimin e automjetit dhe dokumentacionit konform paragrafëve 1 dhe 3 të nenit paraprak e bënë Komisioni i formuar nga Drejtori i Drejtoratit për shërbime publike.

2. Drejtorati i shërbimeve publike pas konstatimit se automjeti taksi i operatorit është i paisur në pajtim të nenit 12 të kësaj rregulloreje i jep operatorit etiketën mbi verifikimin e automjetit për ta vendosur në erëmbrojtës nga ana e brendshme e automjetit.

3.Etiketa nga paragrafi paraprak duhet të jetë nga materiali i qëndrueshëm plastik me bazë për vetëngjitje në qelq të automjeteve dhe duhet të përmbajë: Stemën e Komunës, numrin e regjistrimit të automjetit, numrin e licencës dhe numrin e autoparkingut taksi.

Neni 14 Transporti i udhëtarëve

1.Transporti i udhëtarëve në automjetet taksi bëhet: nga vendparkingjet e destinuara për automjete taksi, sipas thirrjeve të udhëtarëve me mjete të komunikimit, nga vendi i caktuar nga udhëtari dhe kur automjeti është në lëvizje, me kërkesë të udhëtarit për tu ndalur, në vendin e lejuar në të cilin nuk rrezikohet komunikacioni.

2.Drejtuesi i automjetit në autoparking, duhet të ketë kartelën identifikuese dhe të qëndrojë në automjet për marrjen e udhëtarëve.

3. Formën dhe përmbajtjen e karteles identifikuese të drejtuesit të automjetit taksi e përcakton Drejtorati i shërbimeve publike.

Neni 15 Çmimorja e shërbimeve

1. Operatorët duhet të përcaktojnë Çmimoren e shërbimeve të vërtetuar nga Drejtorati për shërbime publike.
2. Çmimorja duhet të përmbajë shënimet e operatorit konform regjistrimit të biznesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit.
3. Çmimorja aplikohet nga dita e vërtetimit nga Drejtorati për shërbime publike.
4. Çmimorja vendoset në automjet afër taksimetrit në vend të përshtatshëm për tu lexuar nga udhëtari.
5. Operatori për shërbimet e transportit i jep udhëtarit dëshminë mbi kryerjen e pagesës.

Neni 16 Ndalesat gjatë ushtrimit të veprimtarisë

1. Gjatë transportit të udhëtarëve me automjete taksi nuk është e lejuar:
 - 1.1 Vendorsja dhe qëndrimi i automjeteve për pranimin e udhëtarëve jashtë vendparkingjeve për automjete taksi,
 - 1.2 Kryerja e transportit të udhëtarëve pa Licencë dhe pa vend të përcaktuar për qëndrim të automjetit në vendparkingjet për automjete taksi,
 - 1.3 Zbritja e udhëtarëve në vendndaljet e autobusëve,
 - 1.4 Bartja e udhëtarëve - fëmijëve nën moshën 6 vjeqare pa përcjellës,
 - 1.5 Bartja e udhëtarëve nën ndikim të alkoolit dhe të narkotikëve,
 - 1.6 Vendorsja në automjet e relacionit dhe emërtimit të vendit të udhëtimit,
 - 1.7 Vendorsja e reklamave në automjet,
 - 1.8 Hijezimi i dritareve të automjetit,
 - 1.9 Pranimi i më tepër se 4 udhëtarëve,
 - 1.10 Bartja udhëtarëve pa tabelën taksi,
 - 1.11 Marrja e udhëtarëve jashtë territorit të Komunës,
 - 1.12 Bartja e mallrave, kafshëve dhe shpezëve ,
 - 1.13 Pimja e duhanit në automjet dhe
 - 1.14 Përdorimi i mjeteve audiovizuele me zë të lartë.

VI. EVIDENCAT

Neni 17 Regjistri i licencave

1. Drejtorati për shërbime publike në formë fizike dhe elektronike mbanë Regjistrin e Licencave të operatorëve për ushtrimin e veprimtarisë me automjete taksi.
2. Regjistri i licencave përmbanë:
 - 2.1 Numrin e licencës,
 - 2.2 Datën e licencës,

- 2.3 Emërtimin e operatorit,
- 2.4 Selinë e operatorit,
- 2.5 Numrin e autojmeteve
- 2.6 Kohëzgjatjen e licencës,
- 2.7 Datën e skadencës dhe
- 2.8 Shënimet për revokim të licencës.

Neni 18 Regjistri i automjeteve

1. Drejtorati për shërbime publike në formë fizike dhe elektronike mbanë Regjistrin e automjeteve të operatorëve të përcaktuara në vendparkingjet për automjete taksi.

2. Regjistri përmbanë:

- 2.1 Numrin e regjistrimit të automjetit,
- 2.2 Markën e automjetit,
- 2.3 Vitin e prodhimit,
- 2.4 Emërtimin e operatorit
- 2.5 Selinë e operatorit
- 2.6 Numrin identifikues të automjetit
- 2.7. Numrin e autoparkingut për qëndrim të automjetit.

VII. DETYRAT PËR ZBATIMIN E RREGULLORES

Neni 19 Obligimet e organeve të Komunës

1. Drejtorati i shërbimeve publike dhe organet tjera të administratës së Komunës në kuadër të kompetencave, në pajtim me ligjin dhe me këtë rregullore kanë obligim për ndërmarrjen e masave dhe nxjerrjen e akteve për zbatimin e kësaj rregulloreje.

2. Drejtorati i Inspektoratit – Inspektorët e trafikut për çdo tre muaj të vitit kalendarik duhet të informojnë me shkrim Drejtoratin e shërbimeve publike mbi masat e ndërmarra të mbikëqyrjes inspektive për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 20 Obligimet e operatorëve

Operatorët, transportin e udhëtarëve me automjete taksi duhet ta kryejnë në pajtim me Ligjin për Transportin rrugor dhe me këtë Rregullore.

VIII. MASAT PËR MOSRRESPEKTIMIN E RREGULLORES

Neni 21 Fletëparaqitja për kundravajtje

Inspektorët komunal të trafikut, perveq masave të parapara me dispozitat e Ligjit për Transportin rrugor, ushtrojnë fletëparaqitje për kundravajtje ndaj operatorëve dhe personave

të cilët, në kundërshtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje, ushtrojnë veprimtarinë e transportit të udhëtarëve me automjete taksi.

Neni 22

Veprimet kundrvajtëse dhe lartësia e gjobave

1. Për veprimet kundërvajtëse do të gjobitet në shumat, si në vijim

- 1.1 - 100 deri 200 Euro personi, i cili pa regjistrim të biznesit dhe pa Licencë ushtron veprimtarinë e transportit të udhëtarëve me taksi.
- 1.2 - 100 deri 150 Euro personi fizik dhe juridik i regjistruar taksi, i cili pa Licencë ushtron veprimtarinë.
- 1.3 - 100 Euro Operatori i licencuar, i cili ushtron veprimtarinë pa të drejtën e shfrytëzimit të autoparkingut për automjete taksi.
- 1.4 - 70 Euro Operatori, i cili ia jep në shfrytëzim automjetin personit që nuk është operator ose i punësuar te operatori, si dhe drejtuesi i automjetit të marrë në shfrytëzim,
- 1.5 - 60 Euro Drejtuesi i automjetit taksi i cili nuk e ka të paisur automjetin konform nenit 12 par. 1.
- 1.6 - 50 Euro Operatori i licencuar me të drejtën e shfrytëzimit të autoparkingut për automjete taksi, për veprimet e cekura në nenin 16 të kësaj Rregulloreje dhe
- 1.7 - 30 Euro Drejtuesi i automjetit taksi i cili nuk posedon në automjet dokumentacionin konform nenit 12 par. 3 të kësaj Rregulloreje.

IX. PROCEDURA E ANKESAVE

Neni 23

Kërkesa për rishqyrtim dhe ankesa

Pala e pakënaqur me Vendimet e bazuara në këtë Rregullore të Drejtoratit për Shërbime publike dhe të Inspektorit të trafikut mund të parashtrojë kërkesë për rishqyrtim të Vendimit - Drejtorit të Drejtoratit për shërbime publike, përkatësisht Inspektorit të trafikutit, ose Ankesë e cila i dërgohet Ministrisë të Infrastrukturës, në afat prej 30 dite nga dita e njoftimit të Vendimit.

X. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 24

Afatet për nxjerrjen e akteve dhe veprimeve për zbatimin e Rregullores

1. Kryetari i Komunës në afat prej 2 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, do të marrë Vendimet për përcaktimin e vendparkingjeve për automjete taksi, për shpalljen e konkursit për dhënien e licencave dhe formimin e Komisionit për shqyrtimin e aplikacioneve sipas konkursit.

2. Drejtorati për shërbime publike, do të përgatisë:

2.1 Në afat në afat prej 2 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje formularin e Licencës të përcaktuar në nenin 4 të kësaj rregulloreje dhe

2.2 Në afat prej 2 muajve nga përfundimi i procedurës së Licencimit paisjet për automjete taksi konform nenit 12 par. 1 nënpar. 1.6, dhe 1.7 si dhe nenit 13 të kësaj rregulloreje.

3. Operatorët, nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje dhe në harmoni me afatet e përcaktuara në paragrafët paraprak , duhet të plotësojnë kushtet për të aplikuar sipas konkursit për marrjen e Licencës për ushtrimin e veprimtarisë, të paise me aktin për të drejtën e shfrytëzimit të parkingut për automjete taksi dhe pas licencimit të përgatisin automjetet dhe dokumentacionin konform nenit 12 dhe 13 të kësaj rregulloreje.

Neni 25

Zgjidhja e kërkesave në procedurë

Kërkesat e pazgjidhura të parashtruara deri në hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, për dhënjen e pëlqimit për ushtrimin e veprimtarisë taksi, do të zgjidhen konform dispozitave të Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksi e datës 04.05.2010, me kohëzgjatje të dhënies së Pëlqimit për ushtrimin e veprimtarisë taksi deri më 31.12.2010.

Neni 26

Afati i pëlqimeve të dhëna për ushtrimin e veprimtarisë

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, afati i kohëzgjatjes së pëlqimeve për ushtrimin e veprimtarisë të dhëna konform dispozitave të Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksi 1Nr.344-479 e datës 04.05.2010, do të skadojë më 31.12.2014.

Neni 27

Afati i licencave

Licencat e lëshuara për operatorët, nga hyrja në fuqi e kësaj Rregullore deri më 31.12.2014, do të lëshohen në kohëzgjatje prej 5 vite nga data 01.01.2015.

XI. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 28

Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për transportin e udhëtarëve me automjete taksi 1Nr.344-479 e datës 04.05.2010.

1Nr. _____
Lipjan , më _____

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

KRYESUESJA E KUVENDIT
Vlora Limani-Hajnuni

Arsyetimi

Baza juridike për të propozuar miratimin e Rregullores është e përcaktuar me dispozitat e nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 40 të Statutit të Komunës së Lipjanit.

Baza juridike për të miratuar këtë Rregullore është e përcaktuar me nenet 11, 12 par.12.2 shkronja c), 16 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 32 par.5 të Ligjit për Transportin rrugor, si dhe neneve 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit.

Me dispozitën e nenit 32 par. 5 të Ligjit për Transportin rrugor parashihet që Komuna të nxjerrë rregullore të veçantë për mënyrën e kryerjes së transportit të udhëtarëve me taksi.

Me dispozitat e nenit 32 të Ligjit për Transportin rrugor rregullohet transporti i udhëtarëve me taksi, të nenit 33 kryerja e transportit taksi dhe nenit 34 përvoja e domosdoshme e shoferit të automjetit taksi.

Me dispozitat e nenit 7 par.1 , 2 dhe 8 të Ligjit për Transportin rrugor parashihet që veprimtaria e transportit rrugor të udhëtarëve me taksi të kryhet në bazë të Licencës që u lëshohet operatorëve në pajtim me Ligjin dhe me akt nënligjor të miratuar nga Komuna.

Duke u bazuar në dispozitat e lartëcekura, në Kapitullin I - Dispozitat e përgjithëshme, me nenin 1 është përcaktuar qëllimi i miratimit të Rregullores që Komuna të krijoj kushte për ofrimin e shërbimeve të transportit të udhëtarëve dhe të rregulloj mënyrën e kryerjes së veprimtarisë të personave fizik dhe juridik të regjistruar për transportin e udhëtarëve me automjete taksi.

Me dispozitën e nenit 2 të Rregullores propozohen qështjet për rregullim:

Subjektet për ushtrimin e veprimtarisë, Licenca dhe kushtet për lëshimin e licencës, procedura e lëshimit, revokimit dhe e marrjes së Licencës, caktimi dhe dhënia në shfrytëzim e vendparkingjeve, ushtrimi i veprimtarisë, evidencat, detyrat për zbatimin e rregullores, masat për mosrespektimin e rregullores, procedura e ankesave, dispozitat kalimtare dhe dispozitat për hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje.

Në vazhdim të Rregullores janë hartuar qështjet sipas radhës së cekur në nenin 2 të Projekt Rregullores.

Me dispozitën e nenit 3 parashifet e drejta për bartjen e udhëtarëve me automjete taksi në territorin e Komunës së Lipjanit nga personat fizik dhe juridik të regjistruar për kryerjen e veprimtarisë të transportit të udhëtarëve me automjete taksi, të cilët do të paisen me Licencë dhe posedojnë automjetet me të drejtë të shfrytëzimit të vendparkingut të caktuar për automjete taksi.

Në kapitujt II dhe III propozohen qështjet për Licencën, kushtet për lëshimin e licencës të cilat duhet ti plotësojnë operatorët dhe automjetet e tyre, procedura e lëshimit të licencës nëpërmjet konkursit publik si dhe rastet kur mund të bëhet revokimi, ndërpreja e afatit dhe marrja e licencës.

Në kapitujt IV dhe V propozohen qështjet për caktimin dhe dhënien në shfrytëzim të vendparkingjeve për automjete taksi, kushtet të cilat duhet ti plotësojnë operatorët për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë dhe veprimet e ndaluara gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Në kapitullin VI parashifet obligimi i Drejtoratit për shërbime publike për të mbajtur evidencat - Regjistrin për Licencat e operatorëve dhe Regjistrin e automjeteve taksi.

Në kapitullin VII propozohen obligimet e organeve të Komunës dhe të operatorëve për zbatimin e Rregullores, në Kapitullin VIII masat për mosrespektimin e Rregullores, në kapitullin IX procedura e ankimit në Vendimet e Dejtoratit për shërbime publike dhe të Inspektorit të Trafikut.

Në kapitullin X propozohen afatet për nxjerrjen e akteve në pajtim të kësaj rregulloreje, zgjidhja e kërkesave të palëve që janë procedurë, afati i Akteve – pëlqimeve të dhëna operatorëve për ushtrimin e veprimtarisë konform dispozitave të Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksi 1Nr.344-479 e datës 04.05.2010, me propozim që ky afat të skadojë më 31.12.2014.

Duke marrë parasysh përgatitjet që duhet bërë për caktimin e vendparkingjeve, përgatitjet e operatorëve për harmonizimin e kushteve me dispozitat e kësaj Rregulloreje dhe procedurat për dhënien e licencave, me nenin 27 parashifet që Licencat e lëshuara për operatorët gjatë periodës nga hyrja në fuqi e kësaj Rregullore deri më 31.12.2014, të lëshohen në kohëzgjatje prej 5 vite nga data 01.01.2015.

Me dispozitat e nenit 28 parashifet që kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës dhe me këtë Rregullore shfuqizohet Rregullorja për transportin e udhëtarëve me automjete taksi 1Nr.344-479 e datës 04.05.2010.

Propozimet dhe sygjerimet përkitazi me këtë Projekt Rregullore gjatë organizimit të diskutimit publik si dhe nga organet e Administratës komunale do të ndihmojnë për të përcaktuar Propozimin për miratimin e Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksi.

1Nr. _____
Lipjan , më _____

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti